



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
QENDRA ARSIMORE POGRADEC**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Pogradec, më 29.09.2023

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**  
**(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

*Data: 29.09.2023*

Drejtuar: Operatorit ekonomik **"BENAKS-94" shpk**, me Nipt J73804663H, me adresë: Korçe Bucimas BUCIMAS Rruga nacionale Pogradec Korçe, Km 1, krahu i djathte, prane kryqezimit Buçimas.

Procedura e prokurimit/lotit: "Proçedurë e Hapur e Thjeshtuar"- "Pune Publike" - "Elektronike",  
Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-76508-08-01-2023**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **"Ndërtim mur mbajtes, Lagja nr. 1, Lumi i Vërdovës"**,

Fondi limit: **4 061 279,21** (katër milion e gjashtëdhjetë e një mijë e dyqind e shtatëdhjetë e nëntë presje njëzet e një) **lekë pa TVSH**,

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: **4 javë nga marrja në dorëzim e sheshit të ndërtimit.**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë, me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. Operatori ekonomik "INA SHPK" shpk**, me Nipt J61814009W

Vlera: 4 008 138 (kater milion e tete mije e njeqind e tridhjet e tetë) Lekë pa TVSH

**2. Operatori ekonomik "BENAKS-94" shpk**, me Nipt J73804663H

Vlera: 3 361 505 (tre milion e treqind e gjashtëdhjetë e një mijë e pesëqind e pesë) Lekë pa TVSH.

**3. Bashkimi i Operatoreve ekonomike "Progress Shkodra" shpk**, me Nipt M17324001D dhe "S.M.O. Union" shpk, me Nipt J66902042Q

Vlera: 3 407 083 (tre milion e katërqind e shtatë mijë e tridhjetë e tre) Lekë pa TVSH

**4. Operatori ekonomik "REJ" shpk**, me Nipt J93711608Q

2 681 971 (dy milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e një) Lekë pa TVSH.

**5. Operatori ekonomik "SARK" shpk** me Nipt K52531415H

Vlera: 3 928 596 (tre milion e nëntëqind e njëzet e tetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) Lekë pa TVSH

**6. Operatori ekonomik "Shëndelli" shpk** me Nipt K07924803N

Vlera: 3 855 181.26 (tre milion e teteqind e pesëdhjetë e pesë mijë e njëqind e tetëdhjetë e një presje njëzet e gjashtë) leke pa TVSH

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik "REJ" shpk, me Nipt J93711608Q, për arsyet e mëposhtme:

Oferta e paraqitur nga OE "REJ" shpk rezulton që të jete Anomalisht e ulet, sipas formulës të zbatuar sipas DT. (Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me LPP.

**Përsa më sipër në zbatim të nenit 93 pika 4 të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe ne nenin 82 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" e ndryshuar, KVO ka derguar kerkese ne sistem per te kerkuar nga OE "REJ" shpk paraqitjen me shkrim te analizës se cmimeve per cdo ze si dhe shpjegime per elemente te vecanta te ofertes per:**

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;

b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik "REJ" shpk në mbështetje të ofertës së paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit, rezulton se ky i fundit nuk është konform kërkesave të përcaktuara në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.

Akoma edhe më tej, referuar shkresës datë 23.08.2023 "Kthim Përgjigje për *Argumentim të ofertes anomalisht të Ulët*" të paraqitur nga operatori "REJ" shpk, rezulton se nuk ka paraqitur bashkëngjitur fatura tatimore për të vërtetuar këtë fakt, konkretisht:

KVO vëren se, OE "REJ" shpk, përveç argumentimit të vet në formën e një preventivi vetdeklarativ (*analize cmimesh*), nuk ka paraqitur prova shkresore për elementet e ofertës sikurse kërkuar (fatura tatimore shitje), për të mbështetur analizën e cmimeve të paraqitura.

- Duke u nisur nga analizat e hartuara nga operatori "REJ" shpk, u vu re se cmimet e perdorura për disa prej "materialeve" nuk përputhen me cmimet e tregut dhe as me cmimet e VKM 629, datë 15.07.2015, të cilit i referohet grupi i projektimit në përllogaritjen e fondit limit.
- Gjithashtu, sipas VKM-se Nr.629, datë 15.7.2015 "Për Miratimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit dhe të Analizave Teknike të Tyre" oret e punës janë të përcaktuara fikse dhe nuk mund të ndryshohen.

Me konkretisht:

1. Në zerin nr. 2.286 + p, Heqje pllaka betoni 8 cm, rezulton që orët e Punës (OP) janë 0.66 ndërkohë që në analizat e paraqitura nga OE "REJ" shpk rezultojnë 0.47.
2. Në zërin An 49 "Prishje struktura prej betoni" rezulton që OP sipas manualit janë 1.75 ndërkohë që në analizat e paraqitura nga OE "REJ" shpk rezultojnë 0.323.
3. Në zërin 3.158/5a "Transport dheu me auto deri 5.0 km", rezulton 5 ton\*km ndërkohë që në analizat e paraqitura nga OE "REJ" shpk rezultojnë 2.62 ton\*km.
4. Në zërin 3.242 "Struktura monolite betoni C 12/15" rezulton që OP sipas manualit janë 13 ndërkohë që në analizat e paraqitura nga OE "REJ" shpk rezultojnë 12.15.
5. Në zerin 3.244 "Struktura monolite betoni C 20/25" rezulton që OP sipas manualit janë 12.8 ndërkohë që në analizat e paraqitura nga OE "REJ" shpk rezultojnë 12.411.

6. Operatori ne kete procedurë prokurimi ka ofertuar me cmime shume te uleta, për materiale ndërtimore, si:
1. Çimento,
  2. Hekur deri Ø 10 mm,
  3. Hekur Ø > 12 mm,
  4. Tubo plasmasi Ø 80mm,
  5. Transport,

Vihet re se, cmimet e paraqitura si më sipër, rezultojnë shumë të ulëta duke i krahasuar me cmimet e tregut si dhe me cmimet e manualit nr. 629, datë 15.07.2015, si dhe nuk janë paraqitur Faturat e Blerjes së këtyre materialeve nga ana e OE "REJ" shpk.

Analiza e cmimeve e cila eshte kërkuar nga autoriteti kontraktor, eshte kerkuar pikërisht për krijimin e bindjes për realizimin me sukses të kontratës edhe me vlerën e ofertuar e cila rezulton anomalisht e ulët. Me anë të analizës së paraqitur, operatori nuk ka mundur të krijojë bindjen tek KVO lidhur me këtë fakt, per shkak se ne analizen teknike rezultojne cmime te materialeve tepër të uleta.

Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, KVO gjykon se nga ana e operatorit ekonomik "REJ" shpk– oferta e të cilit në zbatim të formulës të përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, janë paraqitur sqarime dhe dokumentacion jo i plotë dhe I sakte që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët (në kuptim të: *metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushte përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i punës së propozuar*), duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

Per sa me siper, oferta e "REJ" shpk skualifikohet sepse kjo ofertë nuk është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë: *Operatorin ekonomik "BENAKS-94" shpk*, me Nipt J73804663H, me adresë, Korçe Bucimas BUCIMAS Rruga nacionale Pogradec Korçe, Km 1, krahu i djathte, prane kryqezimit Buçimas, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 3 361 505 (tre milion e treqind e gjashtëdhjetë e një mijë e pesëqind e pesë) Lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë: **Bashkisë Pogradec**, me adresë: Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2 ,sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar, tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe do të procedohet, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO  JO X

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të Procedurës:

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_

**KRYETAR**  
**Ilir XHAKOLLI**

**(ME URDHËR DHE DELEGIM)**  
**NËNKRYETAR**

**Paskalino ZIKO**